



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
P-072

Prishtinë, më 10 tetor 2016, në orën 09:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 10 TETOR 2016

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Zenun Pajaziti, Ismet Beqiri, Albulena Haxhiu, Pal Lekaj, Valdete Bajrami dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyçi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Saniye Berisha dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
2. Kërkesa e deputetit Gëzim Kelmendi, mbështetur edhe nga 44 deputetë të tjerë, për seancë të jashtëzakonshme,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

* * *

1. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se nga seanca plenare, e mbajtur më 7 tetor 2016, janë shtyrë 12 pika të rendit të ditës.

Ai propozoi që 12 pikat e shtyra nga seanca plenare e mbajtur më 7 tetor 2016 të shqyrtohen në seancën plenare më 11 tetor 2016.

Pastaj, kryetari e hapi diskutimin për caktimin e datës për mbajtjen e seancës plenare.

Kryesia pas diskutimit, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të martën, më 11 tetor 2016, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
4. *Votimi për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore,*
5. *Votimi i Projektligjit për investimet strategjike në Republikën e Kosovës,*
6. *Votimi i Propozim-rezolutës lidhur me kodin telefonik shtetëror të Republikës së Kosovës,*
7. *Votimi i Propozim-rezolutës lidhur me situatën aktuale politike në pjesën veriore të Republikës së Kosovës,*
8. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-117 për akreditim,*
9. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta,*
10. *Zgjedhja e një (1) anëtari të Këshillit Prokurorial të Kosovës,*
11. *Shqyrtimi i raportit për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2015,*
12. *Shqyrtimi i raportit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2015.*

2. Kërkesa e deputetit Gëzim Kelmendi, mbështetur edhe nga 44 deputetë të tjerë, për seancë të jashtëzakonshme

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se deputeti Gëzim Kelmendi, mbështetur edhe nga 44 deputetë të tjerë nënshkrues, ka kërkuar që Kuvendi të mbajë seancë të jashtëzakonshme më 11 tetor 2016, në orën 14:00, me këtë pikë të rendit të ditës:

1. Debat parlamentare me rastin e arrestimit të drejtorit të Policisë së Kosovës në rajonin e Mitrovicës, Nehat Thaçi, nga autoritetet e Serbisë

Pastaj, kryetari e hapi diskutimin lidhur me kërkesën e lartshënuar.

Kryesia pas diskutimit vendosi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet të martën, më 11 tetor 2016, në orën 14:00, me këtë:

Rend dite

1. Debat parlamentare me rastin e arrestimit të drejtorit të Policisë së Kosovës në rajonin e Mitrovicës, Nehat Thaçi, nga autoritetet e Serbisë

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

1. Kërkesa për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me Radiotelevizionin e Kosovës

Lidhur me kërkesën e lartshënuar diskutuan: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Albulena Haxhiu, në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Zenun Pajaziti, kryetar i GP të PDK-së, Ismet Beqiri, kryetar i GP të LDK-së dhe Pal Lekaj, kryetar i GP të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve të larshënuara, Kryesia vendosi që kërkesa për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me Radiotelevizionin e Kosovës, në përputhje me afatet ligjore, të radhitet në rend të ditës në njërin nga seancat plenare të radhës.

2. Kërkesa e deputetes Margarita Kadriu-Ukelli, mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputetë të tjerë nënshkrues për debat parlamentar lidhur me detyrimet e mundshme për pretendimet e kompanive që kanë ushtruar padi në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit

Kryesia, pasi diskutoi, vendosi që kërkesa e lartshënuar në përputhje me afatet e parapara me Rregulloren të Kuvendit të radhitet në rend dite në njërin nga seancat plenare të radhës.

3. Kërkesa e znj. Njomza Emini, kryetare e Komisionit për Integrime Evropiane, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Çeki, nga 24-26 tetor 2016

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Anëtarëve të Komisionit për Integrime Evropiane të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Njomza Emini, Valdete Bajrami, Bislim Zogaj dhe Kujtim Paqaku, u lejohet udhëtimi zyrtar në Çeki nga data 24-26 tetor 2016.

2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit (mbulimin e tejkallimit të shpenzimeve për fjetje dhe logjistikë-taksi), si dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Njoftimi i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri, nga 16-18 shtator 2016

Kryesia u njoftua me raportin e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri, nga data 16 deri më 18 shtator 2016.

* * *

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 10:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*